



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:128032  
Datë: 18.03.2024  
Numri i dokumentit: 05464115

AC.nr.993/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj anëtar, në çështjen juridiko kontestimore të paditësve: S. B., E. B., A. B., A. B., R. B. dhe V. B., qe të gjithë nga Peja, të përfaqësuar nga avokati O. C., nga Peja, sipas autorizimit, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. rr. “Nënë Tereza”, nr. 36, Prishtinë, për kompensim dëmi material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.202/2018 të datës 30.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. rr. “Nënë Tereza”, nr. 36, Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.202/2018 të datës 30.11.2020, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.202/2018 të datës 30.11.2020, ka vendosur: hudhet poshtë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. rr. “Nënë Tereza”, nr. 36, Prishtinë, e parashtruar me datë 18.11.2020, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr. 202/2018 datë 22.10.2020, si të paafatshme.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjore, e paditura ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, duke propozuar që gjykata e shkallës së dytë, të aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar, kurse aktvendimin e ankimuar ta prishë dhe lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas ekzaminimit të aktvendimit të ankimuar dhe shkresave të lëndës në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Gjykata Themelore në Pejë, me Aktvendimin e saj Cnr.202/2018 të datës 30.11.2020 ka hedhë poshtë ankesën me arsyetim se e paditura aktgjykimin C.nr. 202/2018 të datës 22.10.2020 e ka pranuar me datë 02.11.2020 ndërsa ankesën e ka paraqitur me datë 18.11.2020, e cila ankesë në gjykatën e shkallës së parë është pranuar me datë 20.11.2020 përmes postes.

Më tej ka arsyetuar se me dispozitat e nenit 186 par. 1 të LPK-së, është paraparë se *“Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejueshme e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”*, ndërsa me paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që *“Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas ankesës, me aktvendimin e ankimuar e ka hedhur poshtë të paafatshme ankesën e të paditurës, e cila është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik, i gjykatës së shkallës së parë me të cilin ka hedhur të paafatshme Ankesën e të paditurës, është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika b), g), j), k) dhe n) të LPK-së për të cilat gjykata kujdeset zyrtarisht, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e gjithashtu nuk përmban edhe shkelje tjera të pretenduara me ankesë.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit me të cilin ka hedhur të paafatshëm ankesën i është përmbajtur dispozitave të nenit 186.1 dhe 2 të LPK-së sipas të cilës dispozitë përcaktohet se *“...ankesa e paraqitur tej afatit të përcaktuar me ligj hedhet poshtë nga gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”* dhe pika 2 sipas së cilës thuhet: *“Ankesa është e pafatshme nëse është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*. Andaj, në rastin konkret, gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar se e paditura aktgjykimin C.nr. 202/2018 të datës 22.10.2018 e ka pranuar me datë 02.11.2020 e që vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjinden në shkresat e lëndës, kundër të cilit aktgjykim e njëjta ka parashtruar ankesë me datë 18.11.2020, që nënkupton se ankesën e ka parashtruar një (1) ditë para skadimit të afatit për parashtrimin e ankesës, përkatësisht në ditën e gjashtëdhjetë (16), e që konstatohet se ankesa është e pasafatshme.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me atë se aktgjykimin C.nr. 202/2018 të datës 22.10.2018, e paditura e ka pranuar me datë 03.11.2020, por të njëjtat pretendime nuk i mori për bazë, pasi që e paditura nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar këtë fakt, përkundrazi në shkresat e lëndës gjendet fletë kthesa mbi dorëzimin e aktgjykimit të cekur më lartë me të cilin vërtetohet se e paditura aktgjykimin e ka pranuar me datë 02.11.2020 dhe e cila e përmban edhe vulën postare e cila është kthyer në postë në po të njëjtën, datën 02.11.2020 dhe jo siç pretendon e paditura që aktgjykimi është pranuar me datë 03.11.2020.

Gjykata e Apelit i analizoj edhe pretendimet tjera të të paditurës të parashtruara me ankesë, por të njëjtat nuk u morën për bazë pasi që të njëjtat nuk kishin ndikim në vendosjen ndryshe në ankesën e të paditurës.

Mbi bazën e të lartcekurave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform dispozitës së nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 nën pikën b) të LPK –së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.993/2021 datë 12.03.2024

Kryetarja e Kolegjit, Gjyqtari  
Besnik Bislimaj, d.v